

<b>Të dhëna bazike të lëndës – SYLLABUSI</b>			
<b>Njësia akademike</b>	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike		
<b>Programi</b>	Komunikacion Rrugor		
<b>Drejtimi / Specializimi</b>	/		
<b>Titulli i lëndës</b>	<b>MEKANIZMAT PËR NGARKIM - SHKARKIM</b>		
<b>Niveli</b>	Master		
<b>Statusi lëndës</b>	Zgjedhore		
<b>Semestri</b>	II (VIII)		
<b>Numri i orëve në javë</b>	2+2		
<b>Vlera në kredi – ECTS</b>	5.0		
<b>Mësimdhënësi i lëndës</b>	<b>Prof. Asoc. Dr. Shpetim LAJQI</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Historia e zhvillimit të mekanizmave për ngarkim – shkarkim. Llojet e mekanizmave për ngarkim – shkarkim. Karakteristikat teknike të pajisjeve për ngarkim shkarkim. Karakteristikat e materialëve që transportohen. Pajisjet për kapjen e ngarkesave. Pajisjet frenuese dhe elementet përbërëse të mekanizmave për ngarkim – shkarkimit. Pajisjet e thjeshta dhe ndihmese për ngarkim - shkarkim. Vinçat e thjeshtë dhe industrial. Skipet e ndërtimit. Pirunjerët. Klasifikimi i pirunjerëve. Rregulla e punës dhe stabiliteti i pirunjerëve. Transportierët me shirit. Transportierët kërmillorë. Elevatorët.		
<b>Qëllimet e lëndës</b>	Aftësimi i studentëve nga lëmia e përdorimit të Mekanizmave për ngarkim – shkarkim me pajisje konvencionale dhe bashkëkohore që përdorën në proceset e ngarkim – shkarkim të mallrave.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies</b>	<p>Studentët pas përfundimit me sukses të këtij kursi, do:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Dijë ti zgjedh mekanizmat adekuat për ngarkim – shkarkimit të mallrave,</li> <li>– Përcaktoj formën dhe madhësinë e njësisë ngarkuese,</li> <li>– Njohë materialet (mallrat) dhe përgatitjen e tyre ngarkim – shkarkim,</li> <li>– Aplikon rregulloret dhe standardet për ngarkim – shkarkim,</li> <li>– Bëjë llogaritjen e kapaciteteve të mekanizmave për ngarkim – shkarkim,</li> <li>– Njohë vetit teknike dhe eksploatuese të pirunjerëve, vinçave, transportierëve me shirit, kërmillorëve, elevatorëve, etj.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	3	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.25	12	3
Ushtrime në teren	0	0	0
Teste, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	2	8	16
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	12	24
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	2	1	2
<b>Totali</b>			<b>128</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies</b>	Ligjërata me prezantime, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime dhe vizitë kompanive. Sipas nevojës mësim online (google meet).		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik:</b>	<b>Pjesa teorike (%)</b>	<b>Pjesa praktike (%)</b>	
	<b>60%</b>	<b>40%</b>	

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<i>Vlerësimi gjatë semestrit:</i> - Testi i I-rë në ligjërata: ... 30% - Testi i II-të në ligjërata: ... 30% - Projekti hulumtues: ... 40% - Ardhja në ligjërata: ... 2.5% - Ardhja ushtrime: ... 2.5% - Angazhimi: ... 5%	<i>Vlerësimi përmes provimit:</i> - Provimi me shkrim: ... 40% - Provimi me gojë: ... 60%
	<i>Notimi:</i> 0 ... 49.9 ..... 5 (pesë) 50.0 ... 60.9 ..... 6 (gjashtë) 61.0 ... 70.9 ..... 7 (shtatë) 71.0 ... 80.9 ..... 8 (tetë) 81.0 ... 90.9 ..... 9 (nëntë) > 91.00 ..... 10 (dhjetë)	
<b>Mënyra e dhënies së provimit</b>	Testimi gjatë vitit, seminarët, dhe/ose provimi përfundimtar.	
<b>Literatura</b>		
<b>Literatura bazë</b>	[1]. Dr. Shpetim Lajqi, Dr. Musli Bajraktari. Mekanizmat për ngarkim - shkarkim. Dispensë për ligjërata, UP/FIM, Prishtinë, 2020. [2]. Dr. Shpetim Lajqi. Mekanizmat për ngarkim - shkarkim. Dispensë për ushtrime, UP/FIM, Prishtinë, 2016.	
<b>Literatura shtesë</b>	[1]. Dr. Musli Bajraktari. Transporti i brendshëm dhe i pandërprerë. Dispensë, UP/FIM, Prishtinë, 2012, [2]. Dr. Musli Bajraktari. Projektimi i mjeteve transportuese. Dispensë, UP/FIM, Prishtinë, 2012. [3]. Dr. Shpetim Lajqi. Modelimi i Sistemeve Logjistike. Dispensë, UP/FIM, Prishtinë, 2020. [4]. Anthony J. Pansini, Handbook of Transportation Engineering, McGraw-Hill, 2003 [5]. Mavrin, I.: Transporteri, Fakultet prometnih znanosti Sveučilišta u Zagrebu, 1999. [6]. Jurić, I.: Prekrcajna mehanizacija-zadaci, nastavni materijal, Fakultet prometnih znanosti Sveučilišta u Zagrebu, 1999.	
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>	
<i>Java e parë</i>	Informimi i studenteve për përmbajtjen e syllabusit. Obligimet dhe mënyra e vlerësimit të studentëve. Hyrje.	
<i>Java e dytë</i>	Historia e zhvillimit të mekanizmave për ngarkim - shkarkim. Llojet e mekanizmave për ngarkim – shkarkim.	
<i>Java e tretë</i>	Mekanizmat me cikël kontinual të organit punës. Makinat dhe pajisjet me cikël të ndërprerë të punës – diskontinual. Parametrat tekniko - eksploatues të mjeteve të transportit të brendshëm.	
<i>Java e katërt</i>	Karakteristikat teknike të pajisjeve për ngarkim shkarkim. Karakteristikat e pajisjeve për punë kontinuale. Karakteristikat e materialit që transportohet.	
<i>Java e pestë</i>	Pajisjet për kapjen e ngarkesave. Pajisjet universale. Pajisjet speciale. Pajisjet jo automatike (manuale). Pajisjet automatike. Pajisjet për kapjen e ngarkesave në copë. Pajisjet kapëse të ngarkesave të hedhëshme.	
<i>Java e gjashtë</i>	Pajisjet frenuese dhe elementet e pajisjeve për ngarkim – shkarkim.	
<i>Java e shtatë</i>	Frenat me nofulla, me shirit, diferencial dhe konik dhe me disqe. Litarët, zinxhirët, polispastet dhe tamburet.	
<i>Java e tetë</i>	<i>Vlerësimi i parë</i>	
<i>Java e nëntë</i>	Pajisjet e thjeshta dhe ndihmese për ngarkim - shkarkim.	

	Kriku i dorës me levë, me vidë dhe hidraulik. Argano me dorë dhe motorik. Çikrikët. Tefleri.
<i>Java e dhjetë</i>	Vinçat e thjeshtë dhe industrial. Vinçi urë. Vinçat portal dhe gjysmë-portal. Vinçat kullë të ndërtimit. Vinçat konsollë. Vinçat e porteve. Vinçat anije. Autovinçat. Vinçat e hekurudhave. Vinç lokomotivë. Skipet e ndërtimit.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Pirunjerët. Klasifikimi i pirunjerëve. Pirunjerët ballor të depove dhe të terrenit. Pajisjet speciale kapëse të pirunjerëve ballor. Rregullat e përgjithshme dhe kushtet e veçanta gjatë punës me pirunjerë. Stabiliteti i bartjes së pirunjerit.
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Transportierët me shirit. Shiriti transportues prej gome. Zgjedhja e shpejtësisë së transportierit. Tamburat dhe rulat e shiritave transportues. Rezistencat e lëvizjes së transportierit dhe fuqia ngasëse.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Transportierët kërmillorë. Njohuri të përgjithshme për transportierët kërmillorë. Elementet përbërëse, kapaciteti dhe fuqia e nevojshme për lëvizjen e transportierit kërmillor.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Elevatorët. Përdorimi i elevatorëve. Elevatorët me kova, pirunjë, luhatës. Elevatorët me kova speciale. Kapaciteti i Elevatorit. Fuqia ngasëse e elevatorit.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	<i>Vlerësimi përfundimtar</i>